



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:068658

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05507791

KA.nr.118/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh. A me seli në rrugën “Nëna Terezë” nr. 36 në Prishtinë, kundër të paditurit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës të Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit administrativ, jashtë seancës, më 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia dhe kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paditësit “Korporata Energjetike e Kosovës” ShA me seli në Prishtinë, me të cilat ka kërkuar anulimin dhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit TEIP Nr. 01-14-73/2022 të datës 20.03.2023 të së paditurit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës të Kosovës me seli në Prishtinë.

A R S Y E T I M

Paditësi në këtë gjykatë më 29.02.2024 kishte iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit TEIP Nr. 01-14-73/2022 të datës 20.03.2023 të së paditurit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës të Kosovës me seli në Prishtinë. Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës kishte konstatuar se padia është jo e plotë ngase nuk është dorëzuar akti administrativ i goditur me padi, andaj më 01.03.2024 përmes aktvendimit KA.nr. 118/24 vendosi që padinë t’ia kthejë Paditësit në plotësim, duke e paralajmëruar atë se nëse nuk i mënjanon të metat e padisë brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, gjykata do ta hedhë poshtë padinë në kuptim të nenit 33 par.2 të LKA-së.

Kjo gjykatë konstaton se Paditësi më datë 12.03.2024 e ka pranuar aktvendimin KA.nr. 118/24 të datës 01.03.2024 të kësaj gjykate, ndërsa nuk ka vepruar sipas këtij aktvendimit. Sipas nenit

33 para. 2 të LKA-së “Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm”.

Prandaj, meqenëse Paditësi nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës të caktuara në aktvendimin për korrigjimin e padisë, ndonëse ishte i paralajmëruar për pasojat, atëherë gjykata në bazë të nenit 33 para. 2 të LKA-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.118/24

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.